



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 2474/Prot.

Tiranë, më 20.10.2025

VENDIM

Nr. 310, Datë 10.10.2025

**“PËR MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONIT TË PROKURORIT
MIRELA KAPO”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar (në mungesë)
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zeqir HODA	Anëtar
5. Arta MANDRO	Anëtar
6. Ledina RIZA	Anëtar (në mungesë)
7. Moisi DUDA	Anëtar
8. Vatë STAKA	Anëtar
9. Olger EMINAJ	Anëtar
10. Erind MERKURI	Anëtar
11. Erion FEJZULLA	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.10.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 18 e vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Për miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit të Prokurorit Mirela Kapo”

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 2474 prot., datë 06.10.2025, të Komisionit të Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, dëgjoi Relatorin Erion Fejzulla, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Pranë Këshillit është administruar me nr. 2413 prot., datë 26.09.2025 kërkesa e magjistratit Mirela Kapo, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me objekt kryerjen e veprimtarisë jashtë funksioni.
2. Siç bëhet e ditur në kërkesë, nga ana e Universitetit të “New York”, Tiranë drejtuar kërkueses, është propozuar angazhimi i saj si pedagoge me kohë të pjesshme, jashtë orarit të punës, për lëndët “E drejta penale” dhe “Procedurë Penale”. Kohëzgjatja e angazhimit do të jetë gjatë gjithë vitit akademik 2025 – 2026.
3. Kërkesa është shoqëruar Vërtetimi nr. 2329 prot., datë 17.09.2025, i Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ku jepet informacion mbi ngarkesën e punës së prokurores, si dhe Vërtetimi nr. 157/2025 prot., datë 19.09.2025, i Universitetit “New York”, Tiranë.
4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit konstaton se, prokurorja Mirela Kapo nuk është subjekt i ndonjë procedimi disiplinor dhe nuk ka masa disiplinore në fuqi.
5. Ushtrimi i veprimtarisë jashtë funksionit në masën dhe kohën e kërkuar nuk ndikon negativisht në ushtrimin e detyrës së tij.
6. Veprimtaria jashtë funksionit në rastin konkret:
 - është në përputhje me dinjitetin e ushtrimit të funksionit;
 - nuk është e papajtueshme me ushtrimin e funksionit të magjistratit dhe nuk ndalohej sipas ligjit.
 - nuk krijon perceptime të ndikimit ose njëanshmëri gjatë ushtrimit të funksionit;
 - nuk bie ndesh me interesat thelbësorë të funksionit, duke mos cenuar afatet dhe ushtrimin në mënyrë efikase të funksioneve.
7. Për sa më sipër, Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit i propozoi Këshillit miratimin e kërkesës së prokurores Mirela Kapo për veprimtarinë jashtë funksioni gjatë vitit akademik 2025-2026, si pedagoge me kohë të pjesshme, jashtë orarit të punës, për lëndët “E drejta penale” dhe “Procedurë Penale”.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 149/a, pika 1, germa “e” dhe 149/ç, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, në nenin 9, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në nenet 164, pika 8, 166 dhe 189, pika 1, germa “a”, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, dhe në nenin 8, të Rregullores “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksioni për prokurorin Mirela Kapo , si pedagoge me kohë të pjesshme, për lëndët “E drejta penale” dhe “Procedurë Penale”, në Universitetin “New York”, Tiranë.
2. Të njoftohet për këtë vendim Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe prokurori Mirela Kapo.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë sot më 10.10.2025.



ZV/KRYETAR
Erind Gërmenji

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Olger Eminaj

ANËTAR
Erind Merkuri

ANËTAR
Erion Fejzulla